



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 63

2002

Tetor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 28/2, datë 26.9.2002	Për miratimin e statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP, Sarandë). 1781
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 28/3, datë 26.9.2002	Për miratimin e statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit(OMP, Vlorë)..... 1781
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 28/4, datë 8.10.2002	Për miratimin e statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP, Fier)..... 1781
Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 28/5, datë 8.10.2002	Për miratimin e statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP, Elbasan).. 1782

URDHËR
Nr. 28/2, datë 26.9.2002

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT
(OMP, SARANDË)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe nenit 31/1 të ligjit nr. 7908, datë 5.4.1995 “Për përkrahimin dhe akuakulturën”,

VENDOSA:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP), Sarandë, që i bashkëngjitet këtij urdhëri.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE USHQIMIT
Agron Duka

URDHËR
Nr. 28/3, datë 26.9.2002

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT
(OMP, VLORË)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe nenit 31/1 të ligjit nr. 7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”,

VENDOSA:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP), Vlorë, që i bashkëngjitet këtij urdhri.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE USHQIMIT
Agron Duka

URDHËR
Nr. 28/4, datë 8.10.2002

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT
(OMP, FIER)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe nenit 31/1 të ligjit nr. 7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”,

VENDOSA:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Fier, që i bashkëngjitet këtij urdhri.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE USHQIMIT
Agron Duka

URDHËR
Nr. 28/5, datë 8.10.2002

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT
(OMP, ELBASAN)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe nenit 31/1 të ligjit nr. 7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”,

VENDOSA:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP), Elbasan, që i bashkëngjitet këtij urdhri.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE USHQIMIT
AGRON DUKA

STATUTI TIP
I ORGANIZATAVE TË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT
(O M P)

Neni 1
Themelimi

Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit ose shkurt OMP-të themelohen në bazë të nenit 31/1 të ligjit nr. 7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”.

Neni 2
Territori dhe selia

1. OMP-ja përdor dhe mirëmban zonën e portit ose qendrës përkatëse që i jepet në përdorim, së bashku me ndërtesat dhe infrastrukturën përkatëse.
2. Selia e OMP-së vendoset brenda këtij territori.

Neni 3
Vula

OMP-ja ka vulën e saj me mbishkrimin: Organizata e Menaxhimit të Peshkimit.

Neni 4
Qëllimi

1. OMP-ja krijohet për interesa publike dhe mbi baza vullnetare.
2. OMP-ja krijohet me qëllim që:
 - a) të menaxhojë, në përputhje me ligjin zonën e portit të peshkimit, të përshkruar në nenin 2 të këtij statuti;
 - b) të sigurojë për anëtarët e saj një mekanizëm për pjesëmarrjen në bashkëmenaxhimin e burimeve peshkore, siç parashikohet në ligj;
 - c) të mbrojë interesat e anëtarëve të saj gjatë tërë procesit të ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit detar dhe të veprimtarive ndihmëse të lidhura me të;
 - d) të sigurojë për anëtarët e saj shërbimet e nevojshme dhe kushtet për zhvillimin normal të veprimtarisë së peshkimit;
 - e) të zhvillojë veprimtari të tjera në përputhje me ligjin.

Neni 5
Anëtarësia

1. Anëtarësia në organizatë përfshin anëtarë pronarë dhe anëtarë jopronarë.
2. I njëjti person nuk mund të jetë edhe anëtar pronar edhe anëtar jopronar në të njëjtën kohë.
3. Anëtarë pronarë të OMP-së janë :
 - a) pronari i një anijeje peshkimi të licencuar dhe të regjistruar për të përdorur portin e peshkimit që menaxhohet nga OMP-ja;
 - b) pronari i një anijeje peshkimi të licencuar për një veprimtari peshkimi të kryer në zonën e bashkëmenaxhimit të OMP-së.
4. Anëtarë jopronarë të OMP-së janë :
 - a) anëtarët aktivë të ekuipazheve të anijeve të peshkimit (kapitenë, inxhinierë apo peshkatarë), që nuk janë pronarë dhe që punojnë rregullisht në peshkim për dy vitet paraardhës;

b) tregtarët që merren me grumbullimin e peshkut të anijeve të peshkimit të OMP-së dhe që kanë stabilimente për ruajtjen dhe përpunimin e peshkut;

c) punonjës të veprimtarive ndihmëse dhe të shërbimit për peshkimin.

5. Anëtari i organizatës regjistrohet detyrimisht në Regjistrin e Anëtarëve të OMP-së. Regjistri është dokumenti bazë që provon anëtarësinë e çdo anëtari.

6. Anëtari i OMP-së pajiset me një dokument identifikimi që tregon anëtarësinë e tij dhe që lëshohet nga OMP-ja.

Neni 6

Anëtarësimi

1. Anëtarësimi në OMP bëhet mbi baza vullnetare dhe duke plotësuar kushtet sipas nenit 5 të këtij statuti.

2. Aplikimi për anëtarësim në OMP bëhet me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar Këshillit Administrativ. Njoftimi për pranim i komunikohet me shkrim anëtarit të ri nga Këshilli Administrativ, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

3. Në rastet kur një anije peshkimi ka mbi një pronar, atëherë vetëm njëri nga bashkëpronarët mund të jetë anëtar pronar i OMP-së. Bashkëpronarët vendosin midis tyre se cili nga ata do të jetë anëtar pronar i OMP-së dhe informojnë me shkrim drejtuesit e OMP-së. Bashkëpronarët e tjerë mund të anëtarësohen si anëtarë jopronarë, në rastin kur ata janë të punësuar në sektorin e peshkimit ku kryen veprimtarinë kjo organizatë.

Neni 7

Ndërprerja e anëtarësit

1. Ndërprerja e anëtarësit bëhet në rastet kur një anëtar përjashtohet ose jep dorëheqjen dhe largohet nga OMP-ja .

2. Vendimi për përjashtimin e anëtarëve merret nga Asambleja e Përgjithshme, në rastet kur:

a) një anëtar thyen në mënyrë të përsëritur statutin, aktet nënligjore, rregullat dhe rregulloret e brendshme të OMP-së;

b) një anëtar thyen në mënyrë të përsëritur dispozitat e ligjit dhe/ose çdo akt nënligjor të zbatueshëm në një zonë bashkëmenaxhimi;

c) një anëtar ka vonesa të pajustificuara të pagesës së tarifave dhe detyrimeve të vëna nga OMP-ja;

d) një anëtar kundërshton të kryejë pagesat e tarifave dhe detyrimeve të vëna nga OMP-ja;

e) një anëtar kundërshton të shlyejë dëmin që i ka shkaktuar pronës së OMP-së;

f) një anëtar nuk kryen në mënyrë të përsëritur detyrat e anëtarit të OMP-së;

g) një anëtar pronar shet anijen e peshkimit ose ndryshon destinacionin e saj për të kryer veprimtari që nuk lidhen me peshkimin;

h) një anëtar jopronar nuk është më i punësuar në peshkim.

3. Çdo anëtar ka të drejtë të japë dorëheqjen nga OMP-ja.

Neni 8

Të drejtat e anëtarëve të OMP-së

Çdo anëtar i OMP-së ka të drejtë:

a) të përfitojë nga shërbimet që ofron OMP-ja ;

b) të marrë pjesë dhe të ndjekë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme;

c) të votojë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet;

d) të kandidojë për t'u zgjedhur në çdo organ të OMP-së;

e) të kontrollojë librat, regjistrat dhe bilancet vjetore të OMP-së;

f) të propozojë çështje për diskutim në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, përsa i përket funksionimit dhe organizimit të OMP-së.

Neni 9

Detyrat e anëtarëve të OMP-së

Çdo anëtar i OMP-së ka për detyrë:

- a) të paguajë çdo detyrim apo tarifë të vënë nga OMP-ja ose në vend të saj të kontribuojë me një punë të caktuar;
- b) të përmbushë dispozitat e statutit dhe rregulloret e OMP-së;
- c) t'i sigurojë OMP-së të gjithë informacionin dhe të dhënat e nevojshme që kërkohen;
- d) të lejojë përfaqësuesit e OMP-së të kontrollojnë mjetin e tij lundrues në çdo kohë, në prani të pronarit të mjetit ose të përfaqësuesve të tij;
- e) të mirëmbajë çdo pajisje apo infrastrukturë që përdoret apo zotërohet nga OMP-ja;
- f) të zbatojë instruksionet e stafit ekzekutiv që janë në pajtim me rregulloret e OMP-së;
- g) të mos japë informacion konfidencial lidhur me veprimtarinë e OMP-së;
- h) të ketë kartën e identitetit të anëtarit.

Neni 10

Organet e OMP-së

1. Organet drejtuese të OMP-së janë Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Administrativ.
2. Organe të tjera të OMP-së janë:
 - a) Komisioni i kontrollit;
 - b) Komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etj.

Neni 11

Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi kryesor vendimmarrës i OMP-së dhe ajo mbledhet të paktën një herë në vit në një mbledhje vjetore të përgjithshme.
2. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Asamblesë thirren nga Këshilli Administrativ, në këto raste:
 - a) kur Këshilli Administrativ e gjykon të nevojshme;
 - b) në bazë të kërkesës me shkrim të atyre që kanë të paktën 10% të numrit total të votave;
 - c) me kërkesën e mbi dy të tretave të anëtarëve të Këshillit Administrativ;
 - d) me kërkesën e Komisionit të Kontrollit.
3. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga Kryetari i OMP-së ose, në mungesë të tij, nga Nënkryetari ose nga ndonjë person tjetër i caktuar nga Këshilli Administrativ.
4. Njoftimi për çdo mbledhje të zakonshme të Asamblesë bëhet për të gjithë anëtarët, të paktën 15 ditë përpara datës së takimit. Sesioni i mbledhjes së Asamblesë mbahet kur janë të pranishëm të paktën 50% e anëtarëve të OMP-së.
5. Tre të pestat e numrit total të votave në Asamblenë e Përgjithshme i përkasin anëtarëve pronarë të OMP-së. Pjesa tjetër e votave i përket anëtarëve jopronarë të OMP-së.
6. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren në mbledhjet e saj. Vendimet merren thjesht me shumicë votash, bazuar në të drejtën e votës sipas nenit 23 të këtij statuti, më përjashtim të rasteve kur:
 - a) të paktën 50% e anëtarëve jopronarë votojnë në favor të një plani bashkëmenaxhimi dhe të çdo akti nënligjor për zbatimin e këtij plani;
 - b) plani i bashkëmenaxhimit përmban veprimtari të ndryshme peshkimi; në këtë rast miratimi i draftit përfundimtar të planit të bashkëmenaxhimit do të vendoset vetëm nga vota e atyre anëtarëve që kryejnë llojin e veprimtarisë së peshkimit që është përcaktuar në planin e bashkëmenaxhimit;

c) zgjidhen anëtarët e Këshillit Administrativ me votim të fshehtë, të cilët zgjidhen në bazë të numrit të votave të marra.

7. Një anëtar pronar që ka më shumë se një anije nuk mund të ketë më shumë se dy të postat e votave që i përkasin anëtarëve pronarë.

8. Një anëtar ka të drejtën të votojë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, vetëm nëse ka paguar të gjitha detyrimet financiare ndaj OMP-së.

9. Për çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme mbahet procesverbali, i cili firmoset nga Kryetari dhe një anëtar i Këshillit Administrativ. Procesverbali ruhet në dokumentacionin e OMP-së.

Neni 12

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën ekskluzive të merret me çështjet e mëposhtme:

- a) miratimin e statutit dhe të shtesave të propozuara në statut;
- b) miratimin e llogarive, raportit vjetor, buxhetit;
- c) miratimin e rregulloreve të brendshme dhe të gjobave për shkeljen e tyre;
- d) miratimin e planit të mirëmbajtjes dhe funksionimit;
- e) miratimin e nivelit të kuotave të anëtarësisë, tarifave apo detyrimeve të tjera që do të vihen për anëtarët e OMP-së, si edhe për të tretët që përdorin portin e peshkimit që menaxhon OMP-ja;
- f) zgjedhjen e Këshillit Administrativ;
- g) ndryshimin e anëtarëve të Këshillit Administrativ, përfshirë edhe Kryetarin;
- h) zgjedhjen e përfaqësuesve të OMP-së në organizmat përfaqësuese kombëtare e ndërkombëtare;
- i) marrjen e vendimit lidhur me shpërndarjen e OMP-së.

Neni 13

Këshilli Administrativ

1. Këshilli Administrativ është organi përgjegjës për menaxhimin e OMP-së. Këshilli Administrativ përgjigjet para Asamblesë së Përgjithshme për mbikëqyrjen e veprimtarisë së OMP-së. Anëtarët e Këshillit Administrativ janë anëtarë të OMP-së dhe veprojnë në interes të saj.

2. Anëtarët e Këshillit Administrativ zgjidhen me votim të fshehtë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për një periudhe deri në katër vjet. Një anëtar i Këshillit Administrativ që ka përfunduar mandatin mund të rikandidojë për t'u zgjedhur. Asnjë person nuk zgjidhet në Këshillin Administrativ, nëse ai ka detyrime financiare të papaguara ndaj OMP-së.

Neni 14

Përbërja e Këshillit Administrativ

1. Këshilli Administrativ përbëhet të paktën nga tre persona, ku të paktën njëri prej tyre është anëtar jopronar dhe pjesëtar i ekuipazhit të një anijeje peshkimi të OMP-së.

2. Në mbledhjen e parë të tij, Këshilli Administrativ zgjedh me shumicë votash Kryetarin dhe Nënkryetarin e OMP-së, si edhe përcakton ndarjen e detyrave për çdo anëtar.

Neni 15

Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Administrativ

Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Administrativ përfshijnë:

- a) zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të kontrollit, të komisionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etj;

- b) rekrutimin dhe shkarkimin e stafit të OMP-së, numri i të cilëve vendoset nga Asambleja e Përgjithshme;
- c) shqyrtimin e kërkesave dhe marrjen e vendimit për anëtarësimin në organizatë;
- d) mbikëqyrjen e kontabilitetit të përgatitur nga ana e stafit ekzekutiv;
- e) nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të OMP-së me organizma e institucione të tjera ;
- f) nënshkrimin e kontratave në përputhje me buxhetin e miratuar, planin e punës dhe planin e përdorimit dhe mirëmbajtjes ;
- g) monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së OMP-së, përfshirë edhe atë financiar;
- h) kontrollin e veprimtarisë së stafit ekzekutiv të OMP-së;
- i) marrjen e vendimit për largimin e ndonjë anëtari të këshillit për një periudhë të përcaktuar;
- j) marrjen e vendimit për largimin e përkohshëm të Kryetarit ose të Nënkyetarit në rast se ata veprojnë në kundërshtim me këtë statut dhe aktet nënligjore të OMP-së, deri në mbledhjen e jashtëzakonshme të Asamblesë për marrjen e vendimit përfundimtar;
- k) kërkesën për mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme;
- l) njoftimin dhe thirrjen e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme ;
- m) përgatitjen e projektbuxhetit vjetor, planit të punës, planit të përdorimit dhe mirëmbajtjes për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
- n) hartimin e rregulloreve të brendshme të OMP-së;
- o) përgatitjen e aktmarrëveshjeve dhe kontratave që lidh OMP-ja me të tretët;
- p) sigurimin e informacionit të nevojshëm në lidhje me veprimtarinë e peshkimit detar, të teknologjisë, të marketingut dhe të sferës së shërbimeve në interes të OMP-së;
- q) ndjekjen e marrëdhënieve me institucionet publike dhe me OMP-të e tjera;
- r) sigurimin për ndjekjen e procedurave financiare dhe administrative të OMP-së.

Neni 16

Mbledhjet e Këshillit Administrativ

1. Mbledhjet e Këshillit Administrativ bëhen çdo muaj dhe drejtohen nga Kryetari ose, në mungesë të tij, nga Nënkyetari i OMP-së.
2. Kryetari ose një e treta e anëtarëve të Këshillit Administrativ kanë të drejtë të kërkojnë mbledhje jashtë radhe të Këshillit Administrativ.
3. Vendimet e Këshillit Administrativ merren me konsensus. Nëse nuk arrihet konsensusi, vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Kryetari ka votën e tij, në rast barazimi të numrit të votave.
4. Mbledhjet e Këshillit Administrativ mbahen kur është e pranishme mbi 50% e anëtarëve të tij.
5. Këshilli Administrativ formulon rregullat dhe procedurat për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të tij.
6. Vendimet e Këshillit Administrativ regjistrohen në procesverbalin e mbledhjeve. Procesverbali firmoset nga Kryetari dhe një anëtar i Këshillit Administrativ.

Neni 17

Kryetari

1. Kryetari zgjidhet me votim të fshehtë nga Këshilli Administrativ dhe është një nga anëtarët e tij. Zgjedhja bëhet për një periudhë dyvjeçare, me të drejtën për t'u rizgjedhur.
2. Detyrat dhe funksionet e Kryetarit janë:
 - a) Drejton mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit Administrativ të OMP-së;
 - b) Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Këshillit Administrativ.
 - c) Propozon stafin ekzekutiv të OMP-së dhe kontrollon veprimtarinë e tij.
 - d) Përgjigjet për mbarëvajtjen e punëve të OMP-së.

e) Përfaqëson OMP-në në marrëdhëniet me institucionet publike dhe me organizatat e tjera kombëtare e ndërkombëtare.

f) është anëtar i bordit të Organizatës Kombëtare të Menaxhimit të Peshkimit.

Neni 18 **Nënkryetari**

Nënkryetari zgjidhet nga anëtarët e Këshillit Administrativ dhe merr detyrat e funksionet e Kryetarit në mungesë të tij.

Neni 19 **Lirimi nga detyra**

1. Lirimi nga detyra i gjithë anëtarëve të Këshillit Administrativ ose i disa prej tyre bëhet me votim nga Asambleja e Përgjithshme.

2. Lirimi bëhet për shfaqje të pandershmërisë, inkompetencës, shpërdorimit serioz të detyrës, si edhe në raste të mosrealizimit të objektivave dhe detyrave të vëna nga OMP-ja në kryerjen e veprimtarisë së saj.

3. Në rast se një anëtar i Këshillit Administrativ lirohet nga detyra në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, zëvendësimi i tij bëhet po në atë mbledhje.

Neni 20 **Komisioni i Kontrollit**

1. Komisioni i Kontrollit përbëhet nga tre anëtarë, të cilët zgjidhen në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Çdo anëtar i këtij komisioni zgjidhet për një periudhë trevjeçare. Një anëtar i Këshillit Administrativ nuk mund të jetë edhe anëtar i Komisionit të Kontrollit.

2. Anëtarët e Komisionit të Kontrollit zgjedhin kryetarin e komisionit, si dhe formulojnë rregullat dhe procedurat e funksionimit të këtij komisioni. Komisioni mban procesverbal për çdo takim të tij.

3. Komisioni kërkon informacione dhe dokumentacione të OMP-së nga Këshilli Administrativ.

4. Detyrat e Komisionit të Kontrollit janë:

a) Bën kontrollin e bilancit vjetor, si dhe gjendjen e të ardhurave dhe të shpenzimeve të OMP-së.

b) Përgatit një raport vjetor për gjendjen e bilancit vjetor, si dhe për të ardhurat dhe shpenzimet dhe e paraqet atë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme;

c) Inspekton periodikisht librat dhe llogaritë e OMP-së.

d) Kontrollon periodikisht inventarin e pasurive të OMP-së.

Neni 21 **Komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve**

1. Komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët zgjidhen në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Çdo anëtar i këtij komisioni zgjidhet për një periudhë trevjeçare.

2. Komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përcakton rastet kur bëhen shkelje të rregullores së brendshme të OMP-së. Komisioni thirret nga Kryetari i OMP-së, kur kjo gjykohet e nevojshme. Komisioni ruan pavarësinë e vullnetit të tij. Në rastet e konstatimit të shkeljes, Komisioni ka të drejtë të gjobisë kundërvajtësin ose t'i propozojë Asamblesë përjashtimin nga OMP-ja të anëtarit që ka bërë shkeljen.

3. Dëgjimi i komisionit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve bëhet në publik. Komisioni ka të drejtë të thërrasë anëtarë të tjerë të OMP-së për të dëshmuar para tij.

Neni 22
Stafi ekzekutiv

1. Stafi ekzekutiv i OMP-së është përgjegjës për zbatimin e planeve operative të punës së OMP-së dhe përgjigjet para Kryetarit.

2. Stafi ekzekutiv është një personel punonjësish që punësohen dhe paguhen nga OMP-ja . Në këtë staf përfshihen menaxheri, financieri dhe punonjës të tjerë të shërbimit e sigurisë, sipas vendimit që merr OMP-ja për këtë qëllim.

3. Numri i stafit dhe koha e punësimit të tij vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, në bazë të propozimit të Këshillit Administrativ.

4. Kontrata e punës dhe personat që punësohen vendosen nga Këshilli Administrativ, në bazë të propozimit të Kryetarit.

5. Stafi ekzekutiv i OMP-së drejtohet nga menaxheri, detyrat dhe kompetencat e të cilit përcaktohen nga Këshilli Administrativ.

6. Anëtarët e Këshillit Administrativ nuk paguhen nga OMP-ja dhe nuk kanë të drejtë të emërohen në stafin ekzekutiv të OMP-së.

Neni 23
E drejta e votës

1. Anëtarët pronarë kanë jo më pak se tre të pestat e numrit total të votave në Asamblenë e Përgjithshme ose në zgjedhje. Pjesa tjetër e votave i takon anëtarëve jopronarë.

2. Ndarja e votave bëhet si më poshtë:

- a) anëtarët jopronarë të ekuipazheve të anijeve me stazh pune më pak se dy vjet në peshkim: 1 votë
- b) anëtarët jopronarë të reparteve ndihmëse: 1 votë
- c) anëtarët jopronarë të kualifikuar (kapitenë, inxhinierë, pronarë stabilimentesh, motoristë, mjeshtra peshkimi, mjeshtra të reparteve ndihmëse e të sektorit të shërbimeve): 2 vota
- d) anëtarët pronarë të anijeve me fuqi motorike deri në 160 Hp: 2 vota
- e) anëtarët pronarë të anijeve me fuqi motorike mbi 160 Hp: 3 vota

3. Anëtarët pronarë që kanë në pronësi më shumë se një anije kanë vota për çdo anije sipas ndarjes në pikën 2 të këtij neni. Pagesat nga ana e tyre bëhen për çdo anije të veçantë, sipas nivelit të kuotave të miratuara në Asamblenë e Përgjithshme.

4. Anëtarët pronarë të anijeve, që kanë edhe stabiliment në pronësi, do të kenë 1 votë më tepër për stabilimentin. Pagesat nga ana e tyre do të bëhen për anijen dhe stabilimentin, sipas nivelit të kuotave të miratuara në Asamblenë e Përgjithshme.

5. E drejta e një anëtari për të ushtruar të drejtën e votës në një mbledhje të Asamblesë zbatohet nëse ai anëtar i ka shlyer gjithë pagesat që i detyrohet OMP-së.

Neni 24
Regjistri i anëtarëve

OMP-ja krijon regjistrin e vet, ku mbahen këto të dhëna:

- a) emri, mbiemri i çdo anëtari;
- b) datëlindja e anëtarit;
- c) profesioni dhe kualifikimi i anëtarit;
- d) forma e peshkimit që ushtron anëtari;
- e) emri i anijes ose i stabilimentit në pronësi për anëtarët pronarë;
- f) vjetërsia e punës në peshkim të anëtarit;
- g) adresa dhe numri i telefonit të anëtarit, etj.

Neni 25

Tarifat që paguhen nga anëtarët e OMP-së

1. Çdo anëtar është i detyruar të paguajë kuotizacionin vjetor të vendosur nga OMP-ja. Kuota e anëtarësisë për çdo anëtar pronar dhe jopronar propozohet nga Këshilli Administrativ dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e OMP-së. Miratimi i nivelit të kuotave të anëtarësisë bëhet nga jo më pak se gjysma e anëtarëve jo pronarë të OMP-së.

2. Niveli i kuotave është i ndryshëm për kategori të ndryshme anëtarësh. Anëtarët pronarë paguajnë kuota më të larta se anëtarët jopronarë. Në propozimin për nivelin e kuotave, Këshilli Administrativ bazohet jo vetëm tek pronësia, por edhe në kapacitetet e mjeteve lundruese që janë në pronësi, vjetërsinë në punë, nivelin e kualifikimit të anëtarëve jopronarë etj. Niveli i kuotave është në përputhje edhe me të drejtën e votës.

3. Me propozimin e Këshillit Administrativ, Asambleja e Përgjithshme miraton edhe një tarifë shërbimi që paguhet nga anëtarët pronarë, për të mbuluar shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes që ka OMP-ja për menaxhimin e portit dhe të veprimtarive të bashkëmenaxhimit të peshkimit. Niveli i kësaj tarife kërkon miratimin e të paktën gjysmës së anëtarëve pronarë.

4. Një person i cili jep dorëheqjen ose përjashtohet nga OMP-ja, në bazë të nenit 7 të statutit, mbetet debitor për të shlyer të gjitha detyrimet e papaguara ndaj OMP-së.

Neni 26

Bilancet financiare

1. Staf i ekzekutiv mban llogari të faturave e të shpenzimeve dhe përgatit një bilanc vjetor, si dhe deklaratat e të ardhurave dhe të shpenzimeve që miratohen çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme. Këto ia paraqit Komisionit të Kontrollit për vërejte, e më pas Këshillit Administrativ për miratim. Afati maksimal për paraqitjen është 60 ditë nga përfundimi i vitit fiskal.

2. Këshilli Administrativ i paraqet për miratimin përfundimtar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Pas miratimit nga Asambleja, Kryetari i OMP-së i paraqet këto dokumentacione në Bordin e Mbikëqyrjes ose në ndonjë agjenci tjetër të kualifikuar për kontroll financiar të jashtëm.

3. OMP-ja është e hapur për çdo lloj kontrolli ligjor dhe mbikëqyrjeje nga organet kompetente të përcaktuara me ligj.

Neni 27

Dokumentacioni i OMP-së

1. OMP-ja mban këto dokumentacione:

- a) regjistrin e anëtarëve të OMP-së;
- b) regjistrin për taksat dhe detyrimet e tjera që paguhen nga anëtarët si dhe shumata e papaguara;
- c) llogari të faturave dhe të shpenzimeve;
- d) bilancin vjetor dhe deklaratën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, që miratohen çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme;
- e) planin e menaxhimit për përdorimin e portit të peshkimit;
- f) planin e bashkëmenaxhimit të peshkimit në zonën bashkëmenaxhuese përkatëse;
- g) regjistrin e protokolleve të mbledhjeve të Këshillit Administrativ;
- h) regjistrin për inspektimet dhe kontrollet;
- i) regjistrin e kontratave ;
- j) inventarin e pasurive.

2. Dokumentacioni i OMP-së është i disponueshëm në çdo kohë për kontroll nga anëtarët.

3. Këshilli Administrativ publikon listën e anëtarëve dhe pagesat e kryera nga ana e tyre në mjediset e selisë së OMP-së.

Neni 28
Fondi i OMP-së

1. Fondi i OMP-së përbëhet nga:
 - a) kuotat e anëtarësisë dhe tarifat e paguara nga anëtarët;
 - b) tarifat e shërbimit të vëna nga OMP-ja për të tretët;
 - c) gjjobat e paguara nga kundërvajtësit;
 - d) donacione të ndryshme ose kredi të marra nga shteti ose institucione të tjera të brendshme apo të jashtme.
2. Fondi i OMP-së përdoret për:
 - a) pagesat për detyrimet e OMP-së;
 - b) pagesat për kostot operative të OMP-së për ndërtim, shfrytëzim, mirëmbajtje, riparim dhe përmirësim të pajisjeve dhe të infrastrukturës së porteve të peshkimit në përdorim;
 - c) blerjen e pajisjeve dhe makinerive që i nevojiten OMP-së;
 - d) pagesën e shpenzimeve të tjera që lidhen me veprimtarinë e OMP-së.

Neni 29
Llogaritë bankare të OMP-së

Fondi depozitohet në llogari të veçantë bankare në emër të OMP-së. Tërheqjet e parave nga banka bëhen nga Kryetari dhe financieri i OMP-së ose, në rast mungese të tij, nga ndonjë person tjetër i autorizuar prej tij. Të ardhura dhe kontribute të tjera të OMP-së depozitohen në llogari tjetër të veçantë bankare.

Neni 30
Shpërndarja dhe likuidimi i OMP-së

1. OMP-ja shpërndahet me vendim të Ministrit, mbi bazën e propozimit Asamblesë së Përgjithshme. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për shpërndarjen e OMP-së merret me dy të tretat e votave të anëtarëve të OMP-së.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendim për shpërndarjen e OMP-së, në rastet kur:
 - a) numri i anëtarëve bie në mënyrë të konsiderueshme;
 - b) nuk arrihen qëllimet dhe objektivat e vëna;
 - c) nuk mund të mbajë më vetveten financiarisht.
3. Pas marrjes së vendimit për shpërndarjen e OMP-së, ndërpritet veprimtaria e saj dhe kalon në likuidim.
4. Likuidimi bëhet në përputhje me ligjet në fuqi dhe sipas procedurave të Kodit Civil.

Neni 31
Miratimi i Statutit

Ky statut miratohet nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme dhe nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 32
Regjistrimi në gjykatë





Me miratimin e statutit, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit regjistrohet në gjykatë dhe njihet si person juridik.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Kodin Civil (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);
- Kodin Zgjedhor (të azhurnuar);
- Kodin Doganor (Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor).



U dorëzua për shtyp më 21.10.2002
Doli nga shtypi më 22.10.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 100 lekë